

Njëra nga çështjet më të diskutuara në politikën ditore në Kosovë, është çështja e demarkacionit të kufirit të Kosovës me Malin e Zi, e cila është bërë edhe njëra nga kauzat kryesore të opozitës së bashkuar.

Por, njëri nga deputetët e parë që e kishte ngritur çështjen e demarkacionit të kufirit të Kosovës me Malin e Zi në Kuvendin e Kosovës, ka qenë ish – deputeti i Partisë së Drejtësisë (PD), Gëzim Kelmendi.

Siç edhe mund të shihet në transkriptin e Kuvendit të Kosovës, të datës 25 mars të vitit 2011, të siguruar nga Telegrafi, Kelmendi, ndër të tjera kishte deklaruar aso kohe se:

“Vonesat e paraqitura në caktimin e vijave të demarkacionit kanë shkaktuar dhe po shkaktojnë probleme. Në kohë të fundit, konkretisht, vitin e kaluar dhe në këtë vit, pjesa perëndimore e Kosovës është duke u ballafaquar me një problem të tillë. Vitin e kaluar siç edhe e dimë, në kufirin Pejë - Kullë - Rozhajë autoritetet malazeze kanë hyrë në tokën e Kosovës për 5.3 km.

Me atë rast, kishin reaguuar popullata e asaj ane e pastaj Kryetari i Komunës së Pejës dhe më pas Ministri i Punëve të Brendshme, Bajram Rexhepi, dhe situata paksa është stabilizuar.

Në këtë vit, në kohë të fundit po përsëritet e njëjta gjë, por në pikën tjetër kufitare Pejë - Qakorr - Morinë.

Autoritetet malazeze kanë hyrë për 7 km në territorin e Kosovës, gjegjësisht në rajonin e Rugovës, konkretisht në rrethinën e Kuqishtës.

Popullata e asaj ane është tejet e shqetësuar dhe e alarmuar, ata kanë reaguuar menjëherë duke iu drejtuar autoriteteve komunale të Komunës së Pejës, por atyre iu është bërë e ditur se kjo çështje nuk është kompetencë e Komunës së Pejës, por është çështje që duhet trajtuar nga qeveria, konkretisht nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Një situatë e tillë dhe shumë alarmante është paraqitur në Radiotelevizionin e Kosovës, me datë 09 mars të vitit 2011. Këto veprime rrezikojnë cenimin e integritetit territorial të Kosovës.

Unë, si përfaqësues i qytetareve të Republikës së Kosovës dhe deputet në Kuvendin e Kosovës shprehi shqetësimin tim të thellë për këtë çështje shumë të ndjeshme dhe shumë vitale për çështjen e Kosovës.

Njëherit, kërkoj nga institucionet e Kosovës, gjegjësisht nga Ministria e Punëve të Brendshme të marrë hapa konkret në këtë drejtim dhe që këtë çështje të caktimit të vijës së demarkacionit me shtetin fqinj Malin e Zi ta zgjidh sa më shpejtë”. /Telegrafi/



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

TRANSKRIPT

I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË  
MBAJTUR MË 25 MARS 2011

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA, ODRŽANE  
25. MARTA 2011. GODINE

MARS – MART  
2011

Gëzim Kelmendi dhe Liburn Aliu, vetëm ju lutem, ta respektoni kohën, i kemi 2 minuta. Pas 2 minutave duhet ta ndërprisni fjalën dhe të shkoni në vend!

**GËZIM KELMENDI:** I nderuar kryetar i Kuvendit,

I nderuari kryeministër,

Të nderuar zëvendëskryeministra dhe ministra,

Kolegë deputetë të nderuar,

Shteti ynë i ri i Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë dhe sot e kësaj dite vazhdon të kalojë nëpër sfida dhe vështirësi të ndryshme. Kjo periudhë e tranzicionit pa dyshim që është një periudhë mjaftë e vështirë dhe me natyrë mjaftë komplekse, prandaj kërkon angazhim dhe përkushtim maksimal të gjithë faktorit politik dhe të qytetarëve të Kosovës në përgjithësi.

5

Jemi një shtet i cili si prioritet ka integrimin në Bashkim Evropian dhe në strukturat veritlantike dhe pa dyshim që angazhohemi për marrëdhënie të mira dhe qeverisje me shtetet fqinje, si Shqipëri, Maqedoni, Malin e Zi dhe Serbinë. Megjithatë, pas shpalljes së pavarësisë shteti ynë i Kosovës po ballafaqohet edhe me një problem mjaftë serioz. Vonesat në caktimin e vijave të demarkacionit të kufijve të Kosovës kanë shkaktuar dhe po shkaktojnë vazhdimisht probleme. Në kohët e fundit pjesa perëndimore e Kosovës është duke u ballafaquar me një problem të tillë. Siç e dimë të gjithë, vitin e kaluar në aksin rrugor Pejë - Kullë - Rozhaje, në kufirin me Malin e Zi autoritetet malazeze kanë hyrë në territorin e Kosovës për 5 kilometra. Patëm pasur reagim të menjëhershëm të popullatës të asaj ane dhe të kryetarit të komunës së Pejës, më pas ka qenë edhe reagimi nga ministri aktual, dr Bajram Rexhepi, i Punëve të Brendshme, dhe situata pak se është stabilizuar. Për këtë të gjithë jemi të njoftuar, por çka është kryesorja që sot desha ta paraqes këtu, se kjo nuk ka të ndalur nga shteti ynë fqinj. Në kohë të fundit është paraqitur problemi në kufirin tjetër, në aksin rrugor Pejë - Çakor - Andrijevicë, ku autoritetet malazeze kanë cenuar integritetin territorial të Kosovës. Qytetarët e asaj ane janë tejet të alarmuar dhe të shqetësuar. Kanë dërguar peticion dhe ankesë në komunën e Pejës, por megjithatë duke pasur parasysh se përgjigja e tyre ka qenë se kjo është kompetencë e Qeverisë, atëherë nuk ka mund të realizohet kërkesa e tyre.

Njeherësh, unë si përfaqësues i qytetarëve të Republikës së Kosovës, deputet nga Partia e Drejtësisë në Kuvendin e Kosovës shpreh shqetësimin tim të thellë për një çështje tejet të rëndësishme dhe vitale për çështjen e Kosovës. Kërkoj nga institucionet e Kosovës, konkretisht nga Ministria e Punëve ...

(Ndërprerje nga regjia)

**KRYETARI:** Faleminderit!

Liburn Aliu e ka fjalën.

**LIBURN ALIU:** Meqë 2 minuta ne kishim llogaritur fillimisht që do të mund të kemi rast për ta pasur fjalën, por po vazhdoj pra shpejt.

Desha të lidhem me çështien e arrestimit të ish ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të